



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 172, Datë 03.04.2024**

**PËR  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES {...}  
PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 03.04.2024, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “*Mbi projektvendimin për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar*”, përgatitur nga relatorja, znj. Emona Muçi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VËREN:**

**I. FAKTET E ÇËSHTJES**

1. Znj. {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 477, datë 20.10.2020 të Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe është caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier) me vendimin nr.506, datë 27.10.2020.
2. Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar kërkesën e gjyqtares {...} për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë një vjeçare, nga data 01.06.2021-01.06.2022.
3. Me vendimin nr.200, datë 31.05.2022 Këshilli ka miratuar kërkesën e gjyqtares për zgjatjen e afatit të lejes së papaguar për arsye familjare, për një periudhë tjetër një vjeçare, deri në datë 31.05.2023 (*duke ezauruar kështu afatin maksimal dy vjeçar të lejes për arsye familjare*).
4. Në kushtet kur leja për arsye familjare përfundonte në datën 01.06.2023, gjyqtarja, ka paraqitur përsëri kërkesë për dhënie leje prindërore për një periudhë 2-vjeçare. Gjithashtu, gjyqtarja në kërkesë e saj ka parashtruar se nëse Këshilli do të vlerësonte se nuk plotësoheshin kriteret ligjore për përfitimin e lejes prindërore, atëherë gjyqtarja kërkonte miratimin e lejes së papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, pasi ishte pranuar për të ndjekur studimet në Universitetin Western Michigan University Thomas M. Cooley Law School, Lansing, Michigan, në programin JD (Juris Doctor). Këshilli me vendimin nr.296, datë 30.05.2023, ka vlerësuar se gjyqtarja nuk është në kushtet e përfitimit të lejes prindërore pasi për këtë kategori ligji ka parashikuar ekzistencën e një viti pune të

pandërprerë. Ndodhur përpara një situatë specifike, ku gjyqtarja ishte në kushtet e përkujdesjes së fëmijës së sapo sjellë në jetë (6/javë), por të pamundësisë për tu trajtuar me leje prindërore për shkak të mospasjes së periudhës 1/vjeçare të qenies në marrëdhënie pune, Këshilli kërkesën e gjyqtarës e ka trajtuar bazuar në Kushtetutë dhe në dispozitat e K.Punës.

5. Në këtë vendim Këshilli ka vlerësuar gjithashtu, edhe pse gjyqtarja {...} ka ezauruar periudhën 2-vjeçare të lejes së papaguar për arsye familjare, sipas përcaktimeve të pikës 8 të vendimit nr.72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar nuk mund të refuzohet derisa fëmija të bëhet 11 muajsh, duke miratuar kështu kërkesën e gjyqtarës për dhënie leje të papaguar për periudhën 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.

6. Në datën 11.03.2024, me nr. 1551 prot., është regjistruar në Këshilli kërkesa e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi profesional në një institucion trajnimi, jashtë programit të trajtimit vazhdues, për periudhën 13.03.2024 deri në 30.09.2024.

7. Në kërkesën e saj gjyqtarja parashtron se: *“Unë, magjistrate {...} ushtroj detyrën si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr.296, datë 30.05.2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është miratuar kërkesa për dhënien e lejes së papaguar, leje prindërore për një periudhë 11 muaj, e cila ka filluar më datë 01.06.2023. Duke qenë se leja e dhënë përfundon me datë **12.03.2024**, parashtroj para jush këtë kërkesë për dhënie leje të papaguar për arsye studimore.....Kërkesa ime për përfitim të lejes së papaguar në kuptim të akteve ligjore të cituara më sipër, ka si shkak ndjekjen e studimeve për qëllime kualifikimi profesional, e cila është një nga llojet e lejeve të parashikuara në ligj. Konkretisht, në datën 23.06.2022 jam pranuar në Universitetin Western Michigan University Thomas M. Cooley Law School, Lansing, Michigan në programin JD (Juris Doctor) për të ndjekur studimet full time. Për shkaqe shëndetësore që lidheshin me periudhën e shtatzënisë, si dhe për shkaqe familjare që konsistojnë në nevojën për përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur, nuk munda të ndjek studimet në muajin shtator 2022, sikundër vijon programi, por vijova ndjekjen e tyre në muajin shtator 2023, në sezonin e vjeshtës. Aktualisht më kanë mbetur edhe 21 kredite për të përfunduar programin”.*

8. Gjithashtu gjyqtarja parashtron se: *“Studimet nuk bien në kundërshtim me profesionin e gjyqtarit, janë brenda të njëjtës fushë. Nga ana tjetër, edhe arsyeja që parashtroj është nga rastet që ligji parashikon si mundësi për magjistratin për të marrë leje të papaguar. Për këtë qëllim kërkoj që të miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor leje e papaguar nga data 13.03.2024 deri në datën 30.09.2024 për të realizuar efektivisht të drejtën për të përfunduar studimet dhe njëkohësisht të kujdesem për vajzën e mitur. E vetëdijshme për situatën aktuale dhe nevojat e sistemit gjyqësor për magjistratë, kërkoj mirëkuptimin e Këshillit në vlerësimin e kësaj situatë faktike dhe miratimin nga ana juaj të lejes së papaguar për një periudhë afërsisht gjatë muaj, me datë fillimi të lejes nga data*

13.03.2024 deri në datën 30.09.2024”.

9. Gjyqtarja i ka bashkëlidhur kërkesës për leje të papaguar vërtetim e qenies studentet pranë universitetit Cooley Law School, lëshuar nga zyra e regjistrimeve të universitetit datë 07.03.2024, si dhe letër pranimit me nr.L41136708, lëshuar nga zyra e pranimeve të universitetit Cooley Law School.<sup>1</sup>

## II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

10. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtarës {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, pasi administroi vendimet e Këshillit me nr.208, datë 20.05.2021, nr.200, datë 31.05.2022 dhe nr.296, datë 30.05.2023 kërkoi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mendimin e kryetarit lidhur me ngarkesën dhe funksionalitetin e gjykatës.

11. Zëvendëskryetarja e Gjykatës, nëpërmjet postës elektronike, në datën 18.03.2024, ka përcjellë të dhënat për ngarkesën aktuale të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë kësaj gjykate.<sup>2</sup> Gjithashtu, ka dhënë mendimin lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, duke u shprehur se: “Duke mbajtur parasysh organikën efektive të gjykatës dhe ngarkesën me punë të gjyqtarëve (referuar të dhënave statistikore të dërguara më herët me e-mail nga kancelarë e gjykatës) duke mbajtur parasysh edhe arsyet specifike familjare dhe profesionale që parashtron znj.{...} në kërkesën e vet, mendoj se miratimi i lejes ë papaguar nga ane Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të Gjykatës”.

12. Pas përfundimit të procedurës si më sipër, në mbledhjen e datës 27.03.2024 Komisioni vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

13. Çështja u morr në shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit në datën 03.04.2024, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të vendimit nr.72, datë 20.05.2019 të KLGJ.

## III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

14. Neni 24 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “1. Përveç pushimeve vjetore, magistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës: a) pushime të tjera; b) leje prindërore...6. Këshilli

---

<sup>1</sup>Me njoftimin e datës 12.03.2024 znj.{...} iu kërkua paraqitja e dokumentacionit në gjuhën shqipe. Në datën 13.03.2024 gjyqtarja depozitoi dokumentacion përkatës të përkthyer në gjuhën shqipe.

<sup>2</sup>Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga gjykata, rezulton se ngarkesa aktuale, në datën e përcjelljes së informacionit është mesatarisht 193 çështje për gjyqtar.

*përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.” (neni 24 pika 6 i Ligjit nr. 96/2016).*

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së këtyre lejeve.

16. Në lidhje me kushtet për dhënien e lejes për qëllime kualifikimi dhe specializimi, pika VI e vendimit nr.72, datë 20.05.2019 *“Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*, parashikon se: *“6. Leja për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jepet nga Këshilli për një periudhë jo më shumë se dy vjet, si me poshtë:*

- a. Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për ndjekjen e këtij trajnimi, afatin e lejes dhe të dhëna për institucionin trajnues. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues, si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;*
- b. Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;*
- c. Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short, të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;*
- ç) Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, nëse kualifikimi profesional ose specializimi nuk përputhet me funksionin e gjyqtarit, ose nëse ajo bie ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë”.*

#### **IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES**

17. Lidhur me lejen e papaguar, në nenin 24 të ligjit nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, parashikohet se magjistrati mund të për përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kriteret për dhënien e lejes së papaguar nga Këshilli dhe njëkohësisht parashikohet se: *“Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.” (neni 24, pika 6 i ligjit nr. 96/2016).* Në bazë të këtij parashikimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së lejeve të papaguara.

18. Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 i ligjit nr.96/2016 dhe vendimi nr.72, datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4, parashikojnë tre lloje të lejes dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore.

19. Në kërkesën e saj znj.{...} kërkon leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion arsimor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për një periudhë 6-mujore, nga data 13.03.2024 deri në datë 30.09.2024.

20. Sa i përket kushteve për dhënien e lejes së papaguar për qëllime kualifikimin dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues, sipas parashikimeve të pikës 6 të vendimit nr.72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, parashikohet si më poshtë:

- (i) Gjyqtari që kërkon lejen duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Këshillit të paktën 30 ditë para fillimit të lejes së kërkuar. Në rastin konkret gjyqtarja ka paraqitur kërkesën me shkrim në datën 11.03.2024 ndërkohë që leja kërkohet të fillohet në datën 12.03.2024. **Pra, afati procedural për paraqitjen e kërkesës të paktën 30 ditë para kohës së fillimit të specializimit për të cilat kërkohet dhënia e lejes nuk është respektuar**, pasi kërkesa është regjistruar në Këshill vetëm 1 ditë përpara përfundimit të lejes së papaguar të miratuar me vendimin nr.296, datë 30.05.2023.
- (ii) Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për të cilën kërkohet leja, kohëzgjatjen saj dhe të dhëna për institucionin pranë të cilit do të zhvillohet aktivitetit kualifikues. Në rastin konkret, në kërkesën e gjyqtares përcaktohet qartë arsye e kërkimit të lejes që konsiston në ndjekjen e një semestri përmbyllës për studimet pasuniversitare të filluara më parë. Gjithashtu, është përcaktuar qartë kohëzgjatja e lejes nga data 12.03.2024 deri në datë 30.09.2024, si dhe është përcaktuar institucioni arsimor pranë të cilit gjyqtarja do të ndjekë studimet për të cilat kërkohet leja.
- (iii) Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues, si dhe mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionaliteti të gjykatës. Në rastin konkret kërkesa e gjyqtares {...} është shoqëruar me dokumentacion justifikues që konsiston në ndjekjen e studimeve *Juris Doctor për avokatinë*. Në lidhje mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionalitet të gjykatës nuk rezulton që gjyqtarja të ketë paraqitur bashkëlidhur kërkesës mendimin e kryetarit të gjykatës, por në lidhje me këtë informacioni Këshilli administroi mendimin e zëvendëskryetares të gjykatës, sipas të cilës rezulton se dhënia e lejes së kërkuar nga gjyqtarja nuk cenon funksionalitetin e gjykatës.

(iv) Leja e kërkuar të mos kalojë afatin maksimal prej 2 vjetësh. Në rastin konkret leja e kërkuar është për një periudhë më të shkurtër se dy vjet dhe konkretisht për periudhën 13.03.2024 deri në 30.09.2024 (6 muaj e 17 ditë).

- Ndërkohë, nga ana e Këshillit u mbajt në vëmendje se me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar kërkesën e gjyqtares {...} për leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë një vjeçare, nga data 01.06.2021-01.06.2022. Me vendimin nr.200, datë 31.05.2022 Këshilli ka miratuar kërkesën e gjyqtares për zgjatjen e afatit të lejes së papaguar për arsye familjare, për një periudhë tjetër një vjeçare, deri në datë 31.05.2023 (*duke ezauruar kështu afatin maksimal dy vjeçar të lejes për arsye familjare*).
- Këshilli me vendimin nr.296, datë 30.05.2023, ka vlerësuar se gjyqtarja nuk është në kushtet e përfitimit të lejes prindërore pasi për këtë kategori ligji ka parashikuar ekzistencën e një viti pune të pandërprerë. Ndodhur përpara një situatë specifike, ku gjyqtarja ishte në kushtet e përkujdesjes së fëmijës së sapo sjellë në jetë (6/javë), por të pamundësisë për tu trajtuar me leje prindërore për shkak të mospasjes së periudhës 1/vjeçare të qenies në marrëdhënie pune, Këshilli kërkesën e gjyqtares e ka trajtuar bazuar në Kushtetutë dhe në dispozitat e K.Punës.
- Në këtë vendim Këshilli ka vlerësuar gjithashtu, edhe pse gjyqtarja {...} ka ezauruar periudhën 2-vjeçare të lejes së papaguar për arsye familjare, sipas përcaktimeve të pikës 8 të vendimit nr.72, datë 20.05.2019 “*Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar nuk mund të refuzohet derisa fëmija të bëhej 11 muajsh, duke miratuar kështu kërkesën e gjyqtares për dhënie leje të papaguar për periudhën 01.06.2023 deri në datë 12.03.2024.
- Gjithashtu në vendimin nr.296, datë 30.05.2023 e Këshillit, gjen pasqyrim edhe kërkesa alternative e paraqitur rishtazi përpara këtij Këshilli “Për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi”, kërkesë e cila, në kushtet kur u pranua leja e papaguar 11 muaj për lindjen e fëmijës, nuk u vlerësua për trajtim të mëtejshëm.

(v) Kualifikimi profesional të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit ose të mos bjerë ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë. Lidhur me këtë kriter, nga informacioni i përcjellë bashkëlidhur kërkesës rezulton se kualifikimi profesional për të cilin gjyqtarja ka kërkuar leje të papaguar për qëllime kualifikimi konsiston në finalizimin e studimeve të filluara më parë në fushën

e avokatisë. Konkretisht, në letrën e pranimit në Universitetin Western Michigan University Thomas M. Cooley Law School, Lansing, Michigan, me numër L41136708 ndër të tjera zyra e pranimit të universitetit thekson se: **“...Në këtë klimë, ne jemi të ndjeshëm ndaj vendimeve që po merrni për të ndjekur ëndrrën tuaj për t’u bërë avokat dhe jetën e përditshme siç e njohim tani....”**. Gjyqtari në paraqitjen e kërkesave për leje dhe Këshilli në procedurën e shqyrtimit të tyre, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe të balancuar të parimit të nxitjes së profesionalizimit dhe zhvillimit të karrierës, sipas të cilit gjyqtari nxitet t’i japë rëndësi vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale. **Përfundimi i studimeve të filluara tashmë në fushën e avokatisë vlerësohet se ka mospërputhje me funksionin e gjyqtarit dhe bie ndesh me interesat kryesore të funksionit.**

21. Për sa më sipër, rezulton se kërkesa e gjyqtares {...} për leje të papaguar për qëllim kualifikimi dhe specializimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues nuk përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”* dhe që lidhen me mosrespektimin e afatit procedural të paraqitjes së kërkesës si dhe mospërputhje me funksionin e gjyqtarit dhe duke rënë ndesh me interesat kryesore të funksionit.

## **V. KONKLUZIONI**

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar, për qëllim kualifikimi dhe specializimi, për një periudhë 6-mujore, nuk përmbush kushtet ligjore dhe ato të përcaktuara në aktin nënligjor të KLGJ dhe si e tillë duhet të refuzohet. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* të ndryshuar, në nenin 24, të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe vendimin nr.72, datë 20.05.2019 *“Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*,

### **VENDOSI:**

1. Refuzimin e kërkesës së znj.{...}, gjyqtare në Gjykatë në Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi, për një periudhë 6-mujore, 13 mars 2024 – 30 shtator 2024.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**